



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUIQËSOR DHE RURAL

PËRMBLEDHJE
RAPORT VJETOR 2024

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	3
1.1. Misioni ynë.....	3
1.2. Baza ligjore e funksionimit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	3
1.3. Organigrama e AZHBR	4
1.4. Objektivat strategjike	5
1.5. Objektivat Kryesore.....	5
1.6. Objektivat e akreditimit	6
2. REZULTATET KRYESORE	6
2.1. Realizimi i fondeve nga Buxheti i Shtetit	7
2.2. Investimet (231).....	7
2.3. Realizimi i Skemave Kombetare	8
2.4. Menaxhimi i fondit për investime sipas masave paraqitet si më poshtë:.....	10
2.5. Menaxhimi i skemës së naftës.....	11
2.6. Statusi i kontratave nga Programi IPARD II.....	12
2.7. Përmbledhje e verifikimeve për masat mbështetëse direkte (1-7)	13
3. EKSPOZIMI NË PROCESET GJYGJËSORE.....	16
4. BURIMET NJERËZORE	16
5. TRAJNIME	17
6. AUDITI.....	17
7. TRAJTIMI I PARREGULLSIVE	19
8. PROBLEMATIKAT	20
9. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM	21
10. SFIDAT PËR VITIN 2025	22

1. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Kjo përmbledhje përfshin objektivat, rezultatet, problematikat dhe rekomandimet për përmirësimin e punës së AZHBR-së gjatë vitit 2024, me fokus te financimet nga buxheti i shtetit dhe programi IPARD II.

1.1. Misioni ynë

Misioni i AZHBR-së është zhvillimi Agrikulturor dhe Rural në Shqipëri duke mbështetur sipërmarrësit në sektorin ushqimor, fermeret ne përfitimin e subvencioneve, përgatitjen e institucionit për përfitimin e fondeve nga buxheti i Bashkimit Evropian, ristrukturim, modernizim dhe specializim në produktet dhe tregjet specifike bazuar në avantazhet konkurruese

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë synon të krijojë një lidhje të ngushtë midis fermerëve, sipërmarrësve dhe institucioneve kombëtare dhe evropiane, duke kontribuar në forcimin e këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë përmes programeve mbështetëse financiare në bujqësi.

1.2. Baza ligjore e funksionimit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), është krijuar në zbatim të Ligjit me Nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si Agjenci e Pagesave”, i ndryshuar me VKM Nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 719, datë 31.10.2014. “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si Agjenci e Pagesave”, me detyra kryesore administrimin e:


1. Fondeve të Buxhetit të Shtetit.
2. Fondeve të Bashkimit Evropian.
3. Fondeve të siguruara nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri.
4. Fondeve kundërparti, të ish-projektit 2KR.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural kryen funksionet e saj aktuale mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 81 datë 10.05.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”.

1.3. Organigrama e AZHBR

Me Urdhër Kryeministri nr. 93, datë 12.06.2024, shfuqizohet Urdhëri nr. 81, datë 10.05.2022 dhe urdhërohet struktura e re e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural e cila do të kryejë funksionin e saj me 253 punonjës, organizuar në 11 drejtori me 27 sektorë.

Struktura e miratuar plotëson të gjitha kriteret e parashtuara në Marrëveshjen Sektoriale, të rekomanduara nga Audituesit dhe është përshtatur për zbatimin e masave kombëtare direkte dhe të Programit IPARD. Mbi bazën e strukturës së re dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike është në proces plotësimi i vendeve vakante të AZHBR.



1.4. Objektivat strategjike

AZHBR është person juridik i Qeverisë Shqiptare nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që ka për qëllim dhënien e mbështetjes financiare si Agjenci Pagesash për financimin e sektorit bujqësor, agropërpunimit dhe zhvillimit rural nëpërmjet pagesave direkte dhe granteve, si dhe trajtimin e sfidave me të cilat përballen sektori i bujqësisë dhe agropërpunimit, si zhvillimi i zonave rurale në mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale duke zbatuar politikat e hartuara për këtë qëllim.

Vëmendje të veçantë i kushtohet përgatitjes së sektorëve, instrumenteve të politikave dhe përshtatjes institucionale për anëtarësimin në BE, për të arritur një përmirësim të qëndrueshëm të konkurrencës së Shqipërisë.

1.5. Objektivat Kryesore

1. Rritja e aksesit të fermerëve dhe përpunuesve në fondet kombëtare dhe ndërkombëtare

Të krijojë dhe promovojë instrumente financiare të përshtatura sipas nevojave të sektorit bujqësor dhe agropërpunues, me synimin për të përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e prodhimeve.

2. Forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin dhe zbatimin efektiv të fondeve të BE-së

Të rrisë kapacitetin administrativ, teknik dhe njerëzor të strukturave të brendshme për të përmbushur standardet e kërkuara nga BE për menaxhimin e fondeve IPARD dhe instrumenteve të tjera të para-anëtarësimit.

3. Zhvillimi i një sistemi efikas monitorimi dhe vlerësimi të projekteve të financuara

Të sigurojë transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet të përdorimit të fondeve publike përmes ndjekjes së performancës së projekteve dhe ndikimit të tyre në zhvillimin rural.

4. Nxitja e inovacionit dhe dixhitalizimit në bujqësi dhe agropërpunim

Të promovojë aplikimin e teknologjive të reja dhe zgjidhjeve inteligjente në zinxhirin bujqësor e përpunues për të përmirësuar efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe konkurrueshmërinë.

5.Promovimi i praktikave të qëndrueshme dhe të gjelbra në bujqësi

Të orientojë mbështetjen financiare drejt praktikave bujqësore që respektojnë mjedisin, ruajnë burimet natyrore dhe mbështesin tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër.

1.6. Objektivat e akreditimit

- ❖ Menaxhimi dhe monitorimi i Fondeve të BE për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për IPARD II;
- ❖ Sigurimi i Imazhit Publik Pozitiv, nëpërmjet realizimit të financimeve në përputhje me Politikën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me qëllim rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë bujqësore;
- ❖ Sigurimi i transparencës dhe reklamimit (megjithëse është një objektivi kryesor i të gjitha institucioneve publike dhe në mënyrën e funksionimit të strukturës së menaxhimit, ekzistojnë disa kërkesa ligjore që i bëjnë këto elemente të detyrueshme);
- ❖ Trajnimi i stafit për programin IPARD III dhe përmirësimi i manualeve operacionale.

2. REZULTATET KRYESORE

Realizimi i fondeve të Buxhetit të Shtetit për subvencionet në masën 100%. U administruan 69,852 aplikime për Skemat Kombëtare, me pagesa në vlerë mbi 5.2 miliardë lekë për subvencionime.

Nga këto:

- Skema direkte (masat 1-7) : 15,593 Aplikime online, 14,937 përfitues, me vlerën e përfitimit 2,907,131,878 lekë
- Skema e naftës (masa 8): 54,255 Aplikime online, 52,190 përfitues, me vlerën e përfitimit 2,282,499,947 lekë
- Skema e Investimeve (masa 9-13): 403 Aplikime me vlere totale të kërkuar 1,244,941,910.75 lekë.

- ❖ Në total janë lidhur 540 kontrata IPARD, 476 kontrata aktive me vlerë totale 10 miliardë lekë. Janë paguar gjatë vitit 2024, 40 kontrata ne vlerën 503,778,528 lekë.
- ❖ Realizimi total i fondeve te buxhetit të shtetit është 98.2%.
- ❖ Rekrutimi i stafit në zbatim të ndryshimeve të structures: janë emëruar 26 punonjës me status dhe 7 punonjës me kod pune.
- ❖ Gjatë vitit 2024 u zhvilluan 46 tema trajnimi për 145 punonjës, me pjesëmarrjen e stafit të brendshëm dhe ekspertëve të jashtëm, në formë fizike dhe online, sipas nevojave të strukturave IPARD dhe Kombëtare.

2.1. Realizimi i fondeve nga Buxheti i Shtetit

Shpenzimet e fondeve buxhetore për artikujt 600, 601, 602, 606 dhe 231, krahasuar me planin vjetor, janë realizuar në masën 98.2%.

Shpenzime, të tjera: transfertat tek individët (606). Më poshtë tabela me zërat përkatës:

Llogaria Ekonom.	ZERAT KRYESORE TE SHPENZIMEVE	Plani	Fakti
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë	2,907,277,845	2,907,131,878
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë (nafta)	2,291,600,000	2,282,592,198
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë (investime)	100,000,000	11,449,415
6061041	Ndihmë e menjëhershme për raste sëmundje e fatkeqësi, etj	180,000	180,000
6061051	Ndihme e menjëhershme financiare për punonjësit	471,400	471,400
6061099	Te tjera transfertat tek individët (rimbursim telefoni)	35,155	35,155
	Shuma 606	5,299,564,400	5,201,860,046

2.2. Investimet (231)

Për investimet IPARD fondi për pjesën 25% dhe 75%: vlerat sa më poshtë duke ndarë dhe pasqyruar sipas projekteve të investimeve të brendshme dhe financimit të huaj paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Llogaria	ZERAT KRYESORE TE SHPENZIMEVE	Plani	Fakti
2310000	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm (25%)	152,554,000	151,902,010
2310000	Shpenzime Kapitale me financim te huaj (75%)	381,500,000	377,875,514
	Shuma	534,054,000	529,777,524

2.3. Realizimi i Skemave Kombetare

Bazuar në Udhëzimin e MBZHR dhe MFE me Nr. 6, datë 07.03.2024, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Sektori i Autorizimit të Pagesave Kombëtare ka kryer procesin e autorizimit të pagesave me dy këste me nga 50% secilin për masat 1-5 dhe masat për fermat organike dhe Global Gap të cilat janë autorizuar në masën 100% me një këst. Në masën 100% janë autorizuar edhe Grup fermërësh si dhe SHBB. Ky është kriter i parashikuar në udhëzim, për të nxitur grupimin e fermerëve si dhe për të rritur fuqinë e tyre negociuese në treg, por edhe për çmimin e shitjes së prodhimeve dhe për të ulur koston e blerjes së imputeve bujqësore.

Gjatë vitit 2024 kanë aplikuar 15,593 fermerë dhe kanë përfituar 14,937 përfitues, me vlerën 2,907,131,878 lekë, si dhe janë autorizuar 52,190 aplikime të skemës së naftës me vlerën 2,282,499,947 lekë.

Realizimi i Skemave të Mbështetjes në Bujqësi:

Nr. Masave referues në udhezim	Masat e Përfitimit	Aplikime/Kërkesa		Buxheti pas Ri-Alokim, AN nr.05, date 19.12.2024 ; Urdher Nr.8519/1, date 31.12.2024		Realizimi	
		Nr.aplikimesh Individe/Grupe	Vlera(Lekë)	Nr.aplikimesh	Vlera(Lekë)	Nr.perfituesish	Vlera (Lekë)
1	Mbështetje per tufen baze te matrikular,krere lope (individual)	3,810	866,154,900	3,810	2,711,546,600	3442	726,352,498
2	Mbështetje per tufen baze te matrikular,krere dele-dhi (individual)	5,429	1,369,693,128	5,432		5,087	1,203,743,400
3	Mbështetje per mbareshttrim bletarie	4,323	464,199,980	4,322		4,056	417,231,500
4	Mbështetje per fara/fidane dhe inpute te tjera (individual)	556	286,220,240	557		464	220,924,200
5	Bime mjekesore dhe aromatike (individual)	945	181,363,566	946		733	143,289,720
1.1	Mbështetje per tufen baze te matrikular,krere lope (grup fermer)	41	12,810,000	41	178,253,400	61	5,780,000
2.1	Mbështetje per tufen baze te matrikular,krere dele-dhi (grup fermer)	5	1,941,300	5		2	1,236,000
3.1	Mbështetje per fara/fidane dhe inpute te tjera (grup ferme,SHBB)	259	281,684,000	259		942	155,993,000
4.1	Bime mjekesore dhe aromatike (grup fermer)	8	19,137,000	8		42	15,183,840
6	Ferme organike	169	26,250,000	169	17,000,000	105	16,800,000
7	Çertifikimi global GAP	48	13,150,000	48	600,000	3	597,720
	Totali (1) 606 me kod 90505AA	15,593	3,522,604,114	15,597	2,907,400,000	14,937	2,907,131,878
8	Mbështetje me nafte per kryerjen e punimeve (NAFTA TOT.) kod projekti 90505AL	54,226	3,538,793,250	54,226	2,291,600,000	52,102	2,273,184,856
		29	20,384,933	29		88	9,315,091
	Totali (2)	54,255	3,559,178,183	54,255	2,291,600,000	52,190	2,282,499,947
12	INVESTIME masa 9 deri 13	403			100,000,000	1	733,050
4	Masa 4/1 (individual)Kesti 2 Sez.2 dhe 1 Çertifikimi global GAP shkr.8519/1						10,253,900
7	dt.31.12.24 per 12 mln						462,465
	TOTALI 1+2	70,251	7,081,782,297	69,852	5,299,000,000	67,128	5,201,081,240

2.4. Menaxhimi i fondit për investime sipas masave paraqitet si më poshtë:

Aplikimet për masat 9-13 u pranuan me dosje fizike nga data 30 Shtator 2024 deri në 8 Nëntor 2024.

Fermer	Person Fizik /Juridik	SHBB	TOTAL
311 (77 %)	89 (22%)	4 (1%)	404

Masa 9 – “Mbështetje për ndërtimin e serave të reja diellore”

Gjatë fazës së aplikimeve janë pranuar gjithsej 29 aplikime, nga të cilat 24 janë aktualisht në proces kontrolli administrativ.

Masa 10 – “Mbështetje për ngritjen e rrjetave për mbrojtje nga breshëri në pemëtore”

Janë pranuar 16 aplikime, prej të cilave 10 janë në fazë kontrolli administrativ.

Masa 11 – “Mbështetje për ndërtimin e stabilimenteve të mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve”

Numri i aplikimeve të pranua është 49, ndërkohë që 33 aplikime ndodhen në proces kontrolli administrativ.

Masa 12 – “Mbështetje për blerje traktorë, makineri dhe pajisje për mekanizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale”

Gjatë fazës së aplikimit janë dorëzuar gjithsej 305 aplikime, prej të cilave 268 janë në kontroll administrativ, ndërsa janë lidhur 23 kontrata, me një vlerë totale granti rreth 39 milion lekë.

Masa 13 – “Mbështetje për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut”

Në total, janë 360 aplikime në fazën e kontrollit administrativ për të gjitha masat, me një vlerë totale të kërkuar për grant me vlerë 1,244,941,910.75 lekë.

2.5. Menaxhimi i skemës së naftës

Për menaxhimin e skemës së naftës për vitin 2024 janë autorizuar dhe janë paguar gjithsej **52,190 aplikime** në shumën **2,228,499,947 lekë**. Fillimi i pagesave për masën e naftës ka filluar në muajin Gusht 2024. Edhe për skemën e naftës është zbatuar autorizimi i pageseës me dy këste, 50% kësti i parë dhe 50% kësti i dytë, Kjo ishte e ndikuar nga fondi që Agjencia kishte në dispozicion, si dhe shtesës së fondit me akt normativ të Këshillit të Ministrave. Mbështetja edhe këtë vit ishte 100% e masës mbështetëse të parashikuar në aplikimet e kryera nga fermerët

Numri i aplikimeve dhe shumat e autorizuara sipas qarqeve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Skema e Naftës për Vitin 2024 sipas ndarjes së AREB-eve.

AREBET	QARQET	Numri aplikimeve të autorizuara	Vlera ne leke e perftuar nga aplikantet	Numri aplikimeve AREB	Vlera ne leke e aplikimeve AREB
AREB SHKODËR	Shkodër	2,933	172,692,536	3,792	220,295,849
	Lezhë	748	43,477,902		
	Kukës	111	4,125,411		
AREB TIRANË	Tiranë	1,972	115,130,798	4,787	249,195,841
	Durrës	1,296	72,475,188		
	Dibër	1,519	61,589,855		
AREB LUSHNJE	Fier	16,108	696,809,470	20,261	918,794,711
	Vlorë	2,754	200,112,689		
	Gjirokastrë	1,399	57,612,558		
AREB KORÇË	Korçë	9,903	403,777,468	23,368	840,213,546
	Elbasan	6,802	244,019,938		
	Berat	6,663	212,416,140		
Totali		52,190	2,228,499,947	52,208	2,228,499,947

2.6. Statusi i kontratave nga Programi IPARD II

- Aplikimet e pranuara në Programin IPARD II**

Thirrja	Masa	Numri i Aplikimeve	Numri i Skualifikimeve	Numri i Tërheqjeve	Numri i Kontratave	Kontrata të Anulluara	Kontrata Aktive	Numri i Amendimeve
1	Masa 1	189	92	2	95	6	89	83
	Masa 3	64	36	1	27	2	25	58
	Masa 7	64	51		13	1	12	28
	Total	317	179	3	135	9	126	169
2	Masa 1	148	51	3	94	10	84	32
	Masa 3	93	48	5	40	3	37	56
	Masa 7	130	67	4	59	7	52	66
	Total	371	166	12	193	20	173	154
3	Masa 1	306	144	8	154	23	131	157
	Masa 3	63	42	4	17	4	13	31
	Total	369	186	12	171	27	144	188
4	Masa 7	132	85	6	41	8	33	54
	Total	132	85	6	41	8	33	54
Total		1189	616	33	540	64	476	565

- Numri i kontratave aktive dhe kontributi publik nën programin IPARD II**

Thirrja	Masa	Numri Kontratave Aktive	Kontributi Publik	Kontributi i BE	Kontributi Kombëtar
1	Masa 1	89	1,170,650,625.59	877,987,969.19	292,662,656.40
	Masa 3	25	1,409,640,272.76	1,057,230,204.57	352,410,068.19
	Masa 7	12	259,117,573.52	194,338,180.14	64,779,393.38
	Total	126	2,839,408,471.86	2,129,556,353.90	709,852,117.97
2	Masa 1	84	1,005,780,085.70	754,335,064.28	251,445,021.43
	Masa 3	37	1,457,761,620.20	1,093,321,215.15	364,440,405.05
	Masa 7	52	970,030,752.15	727,523,064.11	242,507,688.04
	Total	173	3,433,572,458.05	2,575,179,343.54	858,393,114.51
3	Masa 1	131	2,217,188,943.60	1,662,891,707.70	554,297,235.90
	Masa 3	13	830,274,389.00	622,705,791.75	207,568,597.25
	Total	144	3,047,463,332.60	2,285,597,499.45	761,865,833.15
4	Masa 7	33	729,953,953.95	547,465,465.46	182,488,488.49
	Total	33	729,953,953.95	547,465,465.46	182,488,488.49
Total		476	10,050,398,216.46	7,537,798,662.35	2,512,599,554.12


- Realizimi i Fondeve IPARD II Janar - Dhjetor 2024

Masat	Nr.kontratave	Kontributi i BE	Kontributi Publik	Totali
Masa 1	16	152,976,871	50,992,290	203,969,161
Masa 3	6	30,341,610	10,113,870	40,455,480
Masa 7	15	194,203,281	64,734,427	258,937,707
Masa 9	3	353,753	62,427	416,180
Totali	40	377,875,514	125,903,014	503,778,528


Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, Sektori i Kontrollit për Skemat Kombëtare ka realizuar **14,368** verifikime në terren për masat mbështetëse nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2024, si më poshtë:

2.7. Përmbledhje e verifikimeve për masat mbështetëse direkte (1-7)


Nr	Skema mbështetëse	Kontrolle në terren
1	Për tufën bazë të matrikulluar (lopë)	3,552
2	Për tufën bazë të matrikulluar (për të imtat)	5,159
3	Mbarështimi i bletarisë	4,112
4	Mbështetje për serrat	692
5	Mbjellje bimë medicinale dhe aromatike	744
6	Mbështetje për çertifikimin “Ferma Organike”	105
7	Mbështetje për çertifikimin “Global GAP”	4
	TOTALI	14,368



Grafiku (1) Përmbledhje e verifikimeve për masat mbështetëse direkte (1-7)



Grafiku (2) Përmbledhje e verifikimeve për masat mbështetëse direkte (1-7) sipas rajoneve



Grafiku(3) Raporti i verifikimeve krahasuar me vitin 2023

Në zbatim të detyrave për monitorimin e investimeve, janë kryer 165 kontrolle ex-post për të dy programet e mbështetjes, nga këto 41 kontrolle ex-post për projektet përfituese nga “Investime të Skemave Kombëtare” dhe 124 kontrolle ex-post për projektet përfituese nga investimet e financuara nga programi IPARD. AZHBR ka trajtuar gjithashtu raste të veçanta që kanë kërkuar ri-monitorim për shkak të problematikave të konstatuara në terren. Në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe përmirësimit të efikasitetit, janë realizuar veprime për standardizimin e proceseve të monitorimit dhe raportimit teknik e financiar, duke garantuar dorëzimin e raporteve të sakta dhe në kohë ndaj strukturave shtetërore dhe donatorëve ndërkombëtarë.

Krahas këtyre, është punuar në mënyrë të vazhdueshme për përditësimin dhe saktësimin e të dhënave të përfituesve në databazën qendrore, për ndjekjen e detyrimeve kontraktuale, funksionalitetin e investimeve dhe vendosjen e elementëve të vizibilitetit.

3. EKSPOZIMI NË PROCESET GJYQJËSORE

Sektori Juridik është marrë me ndjekjen e proceseve gjyqësore me objekt padie “Përbushjen e detyrimeve kontraktuale”, “Kundërshtim akti administrativ”, pranë Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë, Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatave të Apelit.

Proceset gjyqësore ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Proceset gjyqësore ku AZHBR është palë e paditur, gjithsej janë 16 subjekte.
- Proceset gjyqësore ku AZHBR është palë paditëse, gjithsej janë 52 subjekte.
- Proceset gjyqësore të marrëdhënieve të punësimit, ku është vetëm një rast.
- Proceset gjyqësore ku AZHBR është palë e tretë, gjithsej janë 3 raste.
- Procese gjyqësore të tjera, ku është vetëm një rast.

4. BURIMET NJERËZORE

Gjatë vitit 2024, janë kryer ndryshime të shumta në strukturën e stafit:

Gjatë periudhës raportuese, numri i punonjësve të emëruar në përputhje me strukturën organizative të miratuar ka qenë si më poshtë:

- Janë emëruar gjithsej 26 nëpunës civilë në pozicione të strukturës përkatëse.
 - 7 punonjës janë emëruar me kontratë pune në pozicione brenda strukturës.
 - 17 punonjës janë angazhuar me kontrata të përkohshme pune, për të përbushur nevojat specifike të institucionit.

Procesi i plotësimit të mëtejshëm të strukturës është në vijim dhe parashikohet të realizohen 34 konkurse të tjera, në funksion të përbushjes së të gjitha pozicioneve të parashikuara në organikë.

Sa i përket lëvizjeve nga shërbimi civil, gjatë kësaj periudhe janë liruar nga detyra 21 nëpunës civilë, për arsye të ndryshme, konkretisht:

- 10 nëpunës janë larguar me dëshirën e tyre (dorëheqje);

- 2 nëpunës janë dalë në pension;
- 5 nëpunës janë emëruar në pozicione të tjera;
- 4 punonjës me kontratë pune në strukturë janë larguar për arsye të ndryshme.

5. TRAJNIME

Gjatë vitit 2024 u zhvilluan 46 tema trajnimi për 145 punonjës, me pjesëmarrjen e stafit të brendshëm dhe ekspertëve të jashtëm, në formë fizike dhe online, sipas nevojave të strukturave IPARD dhe Kombëtare.

6. AUDITI

Plani vjetor 2024 i ndryshuar paraqitet si më poshtë:

Nr	Objekte për t'u audituar	Llojet e angazhimeve të auditimit				
		Perputhshmerie	Performance	Financiare	Tek. informacioni	Te kombinuara
1.	Sistemi i proceseve organizative për menaxhimin e fondeve të BE , Programi IPARD II					✓
2.	Sistemi i proceseve operacionale për menaxhimin e fondeve të BE, Programi IPARD II			✓		
3.	Sistemi i pagesave për subvencionet në bujqësi			✓		
4.	Sistemi i funksionimit të DJSHM dhe detyrimeve të prapambetura	✓				
5.	Sistemi i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar			✓		
6.	Auditim tematik lidhur me ankesat e aplikantëve, shqyrtimi i procedurave përjashtimore nr. 13, 14, 15, 16, 17	✓				
7.	Angazhim Auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve në AZHBR	✓				

Tabela nr. 1: Numri i auditimeve të realizuara sipas natyrës së tyre.

Nr.	Emërtimi	Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara
1	Auditime të përputhshmërisë	3	3
2	Auditime të kombinuara	1	1
3	Auditime financiare	3	3
TOTALI		7	7

Në përfundim të auditimit NJAB ka konstatuar statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna ku rezultoi:

- ❖ *Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2021 rekomandimet e lëna në proces rezultojnë të zbatuara.*
- ❖ *Për auditimet e vitit 2022, për 38 rekomandime të dhëna:*
37 rekomandime janë të zbatuara;
1 rekomandim është në proces zbatimi.

Në lidhje me rekomandimin që është ende në proces zbatimi, përkatësisht informacioni më poshtë:

Në të ardhmen të bëhet identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut për sistemin e prokurimeve.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka evidentuar se rekomandimi i lënë rezulton në proces pasi nga DJSHM është planifikuar që do të kryhet procesit i identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut për sistemin e prokurimeve, por ende nuk është finalizuar. Rekomandimi është diskutuar me koordinatorët e riskut, të cilët identifikojnë riskun gjatë proceseve të punës brenda çdo funksioni në AZHBR, të emëruar zyrtarisht me Urdhër të Titullarit të Institucionit.

- ❖ *Për auditimet e vitit 2023, për 22 rekomandime të dhëna:*

20 rekomandime janë të zbatuara;

1 rekomandim është në në proces zbatimi.

Për të gjitha mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm gjatë veprimtarisë në Agjencinë e Pagesave, audituesit kanë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm dhe funksionimin e tij ekonomik, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për sa më sipër janë dhënë 56 rekomandime në lidhje me Funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, si më poshtë vijon:

Totali i rekomandimeve të lëna nga DAB gjatë vitit 2024 janë 56 rekomandime:

- Risk të lartë – 21 rekomandime
- Risk të mesëm – 24 rekomandime
- Risk të ulët – 11 rekomandime

7. TRAJTIMI I PARREGULLSIVE

Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2024 janë trajtuar:

- Parregullsitë e raportuara

Në regjistrin e parregullsive për vitin 2024 janë regjistruar 53 raste parregullsie. 11 parregullsi kanë ardhur nga gjetjet e Autoritetit Auditues, 16 parregullsi janë regjistruar nga raportet e OLAF-it, 21 parregullsi janë regjistruar si pasojë e shkeljeve të kushteve të kontratës së grantit/kushteve të programit IPARD II dhe 5 raste parregullsie janë shpallur nga hetimi administrativ i Sektorit të Identifikimit të Mashtrimit dhe Parregullsive.

- Sinjalet e parregullsive

Gjatë vitit 2024 në regjistrin e sinjaleve janë regjistruar 16 sinjale të ardhur nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë institucionit. Në regjistrin e sinjaleve janë regjistruar 5 Sinjale janë mbyllur read

flag, 6 sinjale janë shpallur parregullsi, 3 sinjale janë raportuar gabimisht, pasi nuk ka asnjë evidence për parregullsi, 2 sinjale janë në proces vlerësimi.

- Përditësimi i regjistrit të parregullsive

Nga Sektori i Identifikimit të Mashtrimit dhe Parregullsisë është realizuar përditësimi i regjistrit të sinjaleve duke ndjekur rregullat dhe procedurat e parashikuara në manualin e procedurave.

Në regjistrin e parregullsisë janë regjistruar 53 raste parregullsie.

8. PROBLEMATIKAT

- Nevojë për përmirësime të sistemeve informatike dhe koordinimin midis drejtorive.
- Nevoja për investime në logjistike.
- Në sistemin e NAFTAES, për shkak se moduli “Autorizim – ekzekutim pagesa” nuk u realizua më tej për procesin e ekzekutimit nga zhvilluesit e sistemit, të gjitha listat e autorizuara për pagesë, janë bërë nga jashtë sistemit dhe listë-pagesat janë realizuar manualisht nga SEP - SK. Kjo nuk pengoi financimin në kohë të fermerëve
- Kalimi i Fondeve në llogarinë IPARD pranë Bankës Intesa dhe ekzekutimi i pagesave brenda të njëjtës datëvalutë, shkakton probleme nëse fondet kreditohen pas cut-off të bankës.
- Problematika të Kredisë 2005 dhe 2009, linja e përpunimit sera etj, të cilat përbëjnë dhe vlerën më të madhe të debitorëve të projektit 2KR, janë të gjithë në proces gjyqësor dhe për disa subjekte në përmbarrim për ekzekutimin e vendimit.
- Mekanika Bujqësore dhëne në vitin 2000-2005, janë ridërguar njoftimet për shlyerje detyrimi në mënyrë vullnetare por arkëtimet janë të ulëta.
- Kredia 2012 -2013 dhe 2014 janë në procese gjyqësore dhe disa në zyrat përmbarrimore.

9. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

- Përmirësim i sistemeve IT dhe digjitalizimi i mëtejshëm. Përveç përmirësimit të sistemeve ekzistuese (PRDB dhe MISS IPARD), sugjerohet hartimi i një Strategjie Kombëtare për Digjitalizimin në Bujqësi, që të përfshijë jo vetëm skemat financiare, por dhe monitorimin në kohë reale të zbatimit të projekteve me GIS, dronë dhe teknologji të gjurmueshmërisë (traceability).
- Rritje e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve dhe bashkëpunimit me institucionet homologe. Sugjerohet hartimi i një pakete të qartë karriere për ekspertët teknikë dhe audituesit, me qëllim uljen e lëvizshmërisë së lartë të stafit dhe rritjen e stabilitetit në pozicione kyçe.
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet bankare dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Efikasiteti në menaxhimin e fondeve të ish-projektit 2KR vijon të mbështesë kërkesën për transferimin e debitorëve si një praktikë e justifikuar, e cila duhet të mbështetet në një analizë të kujdesshme kosto–përfitim dhe në një vlerësim ligjor të rreziqeve, me qëllim shmangien e precedentëve negativë. Gjithashtu, për fermerët që kanë likuiduar mbi 50% të detyrimeve të tyre, sugjerohet aplikimi i një mekanizmi lehtësues — si zbritja e interesit apo pezullimi i përkohshëm i penaliteteve — në vend të faljes së drejtpërdrejtë.
- Përmirësimi i funksionalitetit dhe eficiencës së Sistemit elektronik PRDB sipas problematikave dhe propozimeve të DDMR duke kontraktuar një subjekt/e për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e Sistemit.
- Nevoja për ekspertizë dhe për trajnime për Sigurimin e Cilësisë.

10. SFIDAT PËR VITIN 2025

Në vitin 2025, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR) pritët të përballet me një sërë sfidash komplekse që lidhen ngushtësisht me përmbushjen e objektivave të saj strategjike. Këto sfida burojnë nga nevoja për të forcuar mbështetjen ndaj sektorëve bujqësorë dhe ruralë, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian si dhe me prioritetet kombëtare për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

- **Një ndër sfidat më të rëndësishme mbetet rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e programeve të mbështetjes publike, përfshirë IPARD III dhe Skemat Kombëtare.** Realizimi me sukses i këtyre programeve kërkon jo vetëm përthithjen në kohë të fondeve dhe garantimin e transparencës së plotë në proces, por edhe rritjen e kapaciteteve institucionale. Kjo përfshin fuqizimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, dixhitalizimin e shërbimeve administrative dhe konsolidimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm.
- **Një tjetër sfidë madhore ka të bëjë me përfshirjen më të gjerë dhe të barabartë të fermerëve dhe sipërmarrësve ruralë në skemat e mbështetjes financiare.** Për të siguruar qasje të drejtë dhe të balancuar ndaj fondeve, është e domosdoshme që AZHBR të thellojë bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe vendore, si dhe të intensifikojë përpjekjet për informim dhe trajnime në terren. Vetëm në këtë mënyrë mund të rritet ndërgjegjësimi dhe aftësia e përfituesve potencialë për të aplikuar me sukses dhe për të zbatuar projekte me ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin rural.

- **Ndikimet gjithnjë e më të ndjeshme të ndryshimeve klimatike përbëjnë një sfidë tjetër me pasoja afatgjata për sektorin bujqësor.** Përballja me këto ndikime kërkon orientimin e politikave dhe mbështetjes financiare drejt investimeve të gjelbra, që nxisin eficiencën energjetike, teknologjitë inovative miqësore me mjedisin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës, ujit dhe burimeve të tjera natyrore.

AZHBR mbetet plotësisht e angazhuar për të adresuar në mënyrë të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme sfidat që karakterizojnë zhvillimin rural dhe bujqësor në vend. Kjo përbën një përpjekje të vazhdueshme që mbështetet në një qasje të integruar, e cila ndërthur transparencën institucionale, rritjen e profesionalizmit në të gjitha nivelet e menaxhimit dhe forcimin e bashkëpunimit strategjik me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë institucionet e BE-së, organizatat donatore dhe aktorët e zhvillimit rural.

Përmes kësaj qasjeje, synohet jo vetëm përmirësimi i funksionimit të brendshëm të agjencisë, por edhe ndërtimi i një modeli të qëndrueshëm dhe të besueshëm për mbështetjen e sektorit bujqësor dhe zhvillimit rural në Shqipëri. Ky model synon të krijojë kushte më të favorshme për investime produktive, të përshpejtojë modernizimin e praktikave bujqësore dhe të kontribuojë në fuqizimin ekonomik dhe social të komuniteteve rurale.

Qëllimi përfundimtar i AZHBR-së është që të luajë një rol proaktiv dhe udhëheqës në përshpejtimin e proceseve të zhvillimit rural, duke siguruar që fondet publike të përdoren me përgjegjësi maksimale, me ndikim konkret në jetën e përfituesve dhe në transformimin afatgjatë të sektorit. Në këtë mënyrë, agjencia synon të jetë një hallkë kyçe në realizimin e vizionit kombëtar për një bujqësi moderne, të digjitalizuar, konkurruese dhe të qëndrueshme – një bujqësi që është në linjë të plotë me kërkesat e tregut europian dhe që mbështet integrimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Europian.